

Drejtuar:
Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit Ekonomik
pranë Universitetit të Tetovës

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË
GJITHA THIRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIT MARKETING, TË TJERA (50325, 50329)
NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORE-HULUMTUESE SIPAS
KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË FAKULTETIN EKONOMIK PRANË
UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të konkursit të shpallur më datë 18.Nëntor.2023, në gazetata ditore "Koha" dhe "Sloboden pečat", dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më 29.11..2023, ka sjell Vendim për formim të Komisionit recensues me nr.14-865- 5, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjithë thirjet mësimore-shkencore në lëmin Marketing, të tjera (50325, 50329 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencore-hulumtuese sipas klasifikimit ndërkombëtar të fraskatit), në përbërje:

1. Prof.dr. Raman Ismaili, Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës,
2. Prof.dr. Brikend Aziri, Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës,
3. Prof.dr. Aida Yzeiri-Baftjari, Profesor inordinar në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit të Tetovës.

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni në fjalë vërtetoi se në konkurs janë paraqitur tre kandidat:

1. Dr. Ruzhdi Matoshi, me thirrje të rregullt profesor inordinar, kandidat për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore "Profesor inordinar", bazuar në fletëaplikacion numër 04-03/14.
2. Dr. Selbije Memeti Karemani, kandidat për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore "Docent", bazuar në fletëaplikacion numër 04-06/14.
3. Dr. Iljaz Ameti, kandidat për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore "Docent", bazuar në kërkesën e dorëzuar dhe nënshkruar nga ana e kandidatit.

Pas shqyrtimit të dosjeve të dorëzuara nga ana e kandidatëve, komisioni ka konkluduar me sa vijon:

1. Kandidati Dr. Ruzhdi Matoshi ka dorëzuar dokumentet e kërkuara komform konkursit dhe atë: Thirrje mësimore shkencore "Profesor inordinar" dhënë nga institucion i arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, andaj valide në tërë territorin e saj; Diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike; Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës; Diplomë për gradën shkencore "Doktor i shkencave nga fusha përkatëse; Listë të publikimeve shkencore; Kopje të punimeve shkencore; Biografi të shkurtë; Kopje të disertacionit të doktoratës; Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj; Çertifikatë nga libri amë i të lindurve; Çertifikatë të shtetësisë. Pra, komisioni ka verifikuar

që kandidati ka dorëzuar në tërësi dokumentacionin e kërkuar komform konkursit në fjalë.

2. Kandidati Dr. Selbije Memeti Karemani ka dorëzuar dokumentet e kërkuara komform konkursit dhe atë: Thirrje mësimore shkencore "Docent" dhënë nga institucion i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës; Diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike; Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës; Diplomë për gradën shkencore "Doktor i shkencave nga fusha përkatëse; Listë të publikimeve shkencore; Kopje të punimeve shkencore; Biografi të shkurtë; Kopje të disertacionit të doktoratës; Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj; Çertifikatë nga libri amë i të lindurve; Çertifikatë të shtetësisë. Pra, komisioni ka verifikuar që kandidati ka dorëzuar në tërësi dokumentacionin e kërkuar komform konkursit në fjalë.
3. Kandidati Dr. Iljaz Ameti ka dorëzuar dokumentet në vijim: Çertifikatë të shtetësisë; Biografi të shkurtë; Kopje të disertacionit të doktoratës, Dëshmi për zgjedhje në thirrje "Docent i titulluar" në institucion të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut; Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj.

Komisioni pas shqyrtimit të vëmendëshëm të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e kandidatëve në fjalë, e në përputhëshmëri me kërkesat në nenin 166 të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë dhe kërkesat e vetë Konkursit në fjalë, dorëzon këtë:

RAPORT RECENSUES

Më datë 18. Nëntor.2023, në gazetata ditore "Koha" dhe "Sloboden pečat", dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, është shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmit Marketing, të tjera (50325, 50329 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencore-hulumtuese sipas klasifikimit ndërkombëtar të fraskatit).

Bazuar në dokumentacionin e pranuar, të kandidatëve, komisioni paraqet referat me të dhëna si më poshtë.

Të dhëna biografike

Prof.dr. Ruzhdi Matoshi ka lindur më 06.03.1970 në Tetovë. Arsimin fillorë e ka kryer në shkollën fillore „Liria“ në Tetovë. Arsimin e mesëm e ka kryer në periudhën 1986-1990 në Shkollën e Mesme Gjimanzin „Kiril Pejçinoviç“ në Tetovë në drejtimin matematikorë-natyrorë. Në vitin akademik 1990/1991 regjistron studimet universitare në Fakultetin e Bujqësisë pranë Universitetit të „Prishtinës“ në Prishtinë dhe i vazhdoi në vitin e III në vitin 1993/1994 në Universitetin Bujqësorë të Tiranës Fakultetin e Agronomisë ku diplomon më datë 07.03.1996. Në vitin 2002 regjistron studimet pasdiplomike në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të „Prishtinës në Prishtinë“. Më datë 14.12.2010 me sukses mbron disertacionin e magjistraturës në temë „Modelet e privatizimit të pronës shoqërore në Bujqësi me theks të veçantë në rajonin e Pollogut “ dhe merr gradën shkencore Magjistër i Shkencave Ekonomike (MSc) . Më 12.04.2014 Ruzhdi Matoshi mbroji me sukses punimin e doktoratës në temë „Hulumtimi i strategjive për zhvillimin e Agrobiznesit – Rast studimi Rajoni i Pollogut“ në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit „Shën Kirili e Metodij“ në Shkup.

Prof. dr. Ruzhdi Matoshi menjëherë pas diplomimit punësohet në Komunën e Shtërpcës Republika e Kosovës si drejtor i Urbanizmit, më vonë drejtor në kopertativën Bujqësore Rakaj dhe menjëher pas zgjedhjeve komunale mer besimin edhe si Nënkryetarë i komunës së Shtërpcës deri në vitin 2001. Në Shtator, 2002 Zgjidhet Deputet në Parlamentin e Maqedonisë duke perfunduar mandatin e plotë deri në vitin 2006. Në zgjedhjet Parlamentare të rradhës -2006, fiton mandatin e dytë duke mos e perfunduar deri në fund dhe në zgjedhjet e parakohshme 2008 nderpret aktivitetin parlamentar si perfaqësues i popullit ne Parlamentin e Maqedonisë së veriut. Ruzhdi Matoshi si deputet i parlamentin të Maqedonisë së Veriut kreu shume funksione edhe ate; Ka qenë anëtar i delegacionit parlamentar të RM – së të Kuvendit Parlamentar pranë Keshillit te Evropës në Strazbur të Francës si dhe anëtarë i Komisionit për kulturë pranë Këshillit të Evropës; anëtar i delegacionit parlamentar të RM– së pranë OSBE – se me seli në Vjenë ; anëtar i trupit punues për zhvillim demokratik parlamentar të RM– së pranë West Minster Foundation for Democracy; anëtar i delegacionit parlamentar të RM–së pranë Unionit Interparlamentar (IPU) dhe anëtarë i Komisionit për barazi gjinore pranë këtij Unioni; anëtar i Bordit Parlamentarë për themelim, strukturim dhe funksionim

të Institutit Parlamentarë të Kuvendit të RM –së; anëtar i KOFAK (Organizatë konferenciale e komisioneve parlamentare të politikës së jashtme të shteteve anëtare të BE – së si dhe atyre aspirante) si kryetar i Komisionit për politikë të jashtme pranë Kuvendit të RM – se; anëtar i Unionit të Evropës Perëndimore me seli në Paris të Francës etj. Si anëtar i këtyre organizatave ka marrë pjesë në seminare, stërvitje e konferenca të shumta në vend si dhe jashtë vendit: La Valeta (Malta, 2006), Andora (Andora, 2007) – Konferenca parlamentare të OSBE –së; Berlin (Gjermani, 2007), Helsinki(Finlandë,2006) – KOFAK Konferenca; Nusa-Dua,Bali (Indonezi, 2007), Cirihi (Zvicër, 2009, 2010 dhe 2011)- Konferenca të Unionit Interparlamentar ; Paris (Francë, 2008) – Konferencë të Unionit të Evropës Perëndimore ; stërvitje për lobim për NATO dhe BE integrimi si dhe për punën e komisioneve parlamentare nga ana e USAID , NDI dhe Shtëpia për Partneritet Demokratik në Washington DC të SHBA –ve (2007 dhe 2008); Kopenhagë (Danimarkë, 2009), Strazbur (Francë, 2008 – 2011) – Kuvendi parlamentarë pranë Këshillit të Evropës; stërvitje në Budapestë (Hungari, 2008) për drejtësi dhe siguri të brendshme ; Konferencë e grave deputete të regjionit e organizuar nga OSBE në Tiranë (Shqipëri, 2008) dhe Sarajevë (Bosnjë, 2009); konferenca dhe debate publike në Maqedoni (Shkup, Ohër, Mavrovë 2006 – 2011.

Gjatë pjesëmarrjeve në këto konferenca, përkrah prononcimeve dhe fjalimeve gojore, kandidati ka patur edhe fjalime në formë të shkruar edhe atë për temat: “Imigrimi, integrimi dhe dialogu ndërkulturor“, “Roli i subjekteve politike në promovimin e pjesëmarrjes së gruas në politikë“, “Deri në BE pa viza“, “Islami, Islamizmi dhe Islamofobia “, “ Lufta kundër krimit të organizuar“, “Roli i rinisë në proceset demokratike“, “ Marrëveshja e Lisbonit, “Maqedonia dhe BE-ja“, “Deputetët dhe raportet mediale “, “ Gratë dhe kriza ekonomiko – finansiare “etj.

Në vitin 2011, kandidati, Prof.dr.Ruzhdi Matoshi punësohet si asistent në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, deri në marjen e titullin Doktor Shkence nga fusha e Ekonomisë, në vitin 2014 në Universitetin Kiril dhe Metodij – Fakultetin Ekonomik në Shkup, dhe nga data e marjes së këtij titulli, kandidati vazhdon angazhimin e tij në po të njëjtin Universitet, si Profesor Asistent, (Docent), i rregullt duke ushtruar edhe detyrën e Dekanit dhe të prorektorit në po të njëjtin Universitet (Universitetin Ndërkombëtar të Strugës), përgjatë periudhës 2015-2020. Në të njëjtin Universitet, kandidati, pajiset edhe me thirjen shkencore-profesionale, inordinar, në vitin 2021. Në mes të tjerave, kandidati përgjatë periudhës 2016-2017, ka ushtruar edhe detyrën e drejtorit në agjencionin e agronomisë së Republikës së Maqedonisë, AGROBERZA. Në jetën akademike, ka ushtruar mësimdhënie në Universitetin e Pejës, Haxhi Zeka përgjatë periudhës së viteve akademike, 2016-2018, në Universitetin e Prizrenit, Ukshin Hoti, përgjatë periudhës së viteve akademike 2017-2018, në Universitetin e Mitrovicës, përgjatë periudhës së viteve akademike 2016-2017, kolegjin Arbëria, Gjilan, përgjatë viteve akademike 2015-2016 dhe kolegjin UBT-Prishtinë, përgjatë periudhës së viteve akademike 2016-2023.

Vlen të potencohet fakti, që kandidati në fjalë një kohë të gjatë angazhimin e mësimdhënies në ciësi të profesorit inordinar e ushtron edhe në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tetovës, si ligjerues me kohë të pjesshme (part-time), përgjatë periudhës së viteve akademike 2018-2023.

Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore

Veprimtaria mësimore e Prof. Dr. Ruzhdi Matoshit mund të përshkruhet si mjaft e bujshme, aktive dhe e suksesshme. Në fakt, kandidati në fjalë ka një përfshirje në mësimdhënie si brenda po ashtu edhe jashtë vendit.

Në periudhën pas marrjes së thirrjes mësimore -shkencore Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, Dr. Ruzhdi Matoshi ka ligjëruar një sërë të lëndëve në studimet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, kolegjinë UBT-Prishtinë, Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, Kolegjin "Arbëria" në Gjilan dhe Fakultetin Ekonomik të Universitetit Ukshin Hoti në Prizren si dhe në Fakultetin Ekonomik, në Universitetin Isa Boletini në Mitrovicë.

Në Universitetin e Tetovës, Prof.dr. Ruzhdi Matoshi në periudhën përgjatë viteve akademike 2018-2023 ka ligjëruar në vazhdimësi në studimet e ciklit të parë në lëndët: Distribucioni, kërkimet e tregut, kërkimet e marketingut dhe Sistemet Ekonomike Bashkëkohore.

Në kolegjin UBT në studimet e ciklit të dytë, kandidati Dr. Ruzhdi Matoshi ka ligjëruar lëndën Intershipi dhe zhvillimi profesional, menaxhimi i pushtetit lokal dhe financat. Në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës në ciklin e dytë, kandidati ka ligjëruar në lëndët – E-ekonomia. Në Universitetin e Pejës, në ciklin e dytë ka ligjëruar lëndën Tregu i Punës dhe Menaxhimi i Biznesit.

Prof.dr. Ruzhdi Matoshi ka mentoruar gjithsej 10 kandidatë në përpilimin dhe mbrojtjen me sukses të punimeve të magjistraturave pranë Universitetin Ndërkombëtar të Strugës dhe kolegjit UBT ndërsa në ciklin e parë, ka mentoruar gjithsej 40 kandidatë në kolegjin UBT-Prishtinë.

Prof.dr. Ruzhdi Matoshi, në këtë periudhë ka publikuar një dispensë universitare:

- Ruzhdi Matoshi: "Sistemet Ekonomike Bashkëkohore", Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2021

Siç mundet të vërehet dhe nga tabelat në shtojcë të raportit, Prof. dr. Ruzhdi Matoshi në periudhë në fjalë ka grumbulluar gjithsej 194.15 pikë në pjesën e veprimtarisë së tij mësimdhënëse dhe arsimore.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese

Në periudhën pas marrjes së thirrjes mësimore-shkencore Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, prof.dr. Ruzhdi Matoshi ka shënuar suksese adekuate edhe në pjesën e veprimtarisë shkencore-hulumtuese.

Në këtë drejtim, ai në vazhdimësi ka kontribuar në ndërtimin e gjeneratave të reja të hulumtuesve përmes mentorimit të disertacioneve në ciklin e dytë në Fakultetin

Ekonomik pranë Universitetit të Ndërkombëtar të Strugës dhe në UBT si dhe punimeve të magjistraturës në Fakultetin Ekonomik pranë kolegjit UBT-Prishtinë, Fakultetin e Biznesit pranë Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë. Kështu, në rrjedhë ka të raportuara dhjetë mentorime të disertacioneve të magjistraturës dhe ka qenë anëtar komisioni në disertacione doktoratura në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës.

Në periudhën në fjalë Prof.dr. Ruzhdi Matoshi ka të publikuara një varg të punimeve shkencore në revista relevante ndërkombëtare dhe vendore, edhe atë:

1. Matoshi, R., (2016). Do haccp and iso standards affect key performance indicators in agribusiness? Evidence from case studies in the polog region of Republic of Macedonia, Bratislava Slovakia, SKAP E-CONFERENCE, 14 www.skaponline.com
2. Matoshi, Ruzhdi, "Agritourism potential as a perspective in Kosovo" (2016). *UBT International Conference*. 24. <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2016/all-events/24>: DOI 10.33107/ubt-ic.2016.24
3. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2017). Education for business or the business of education?: The case of higher education in Kosovo. In Book of Proceedings (p. 188). DOI 10.21520/C.4-2017.
4. Matoshi, R., & Veseli, B. (2018). Economic Growth in Kosovo as a Challenge to Environmental Preservation in the Republic of Kosovo. *European Journal of Marketing and Economics*, 1(2), 26-34. DOI: <https://doi.org/10.26417/ejme.v1i2.p26-34>
5. Matoshi, R., & Veseli, B. (2017). Organic Food Perspective in Developing Countries: An Overview of Polog Region and a Case Study in the Republic of Macedonia. *European Journal of Multidisciplinary Studies*, 2(6), 9-16. DOI: <https://doi.org/10.26417/ejms.v6i1.p9-16>
6. Matoshi, R. (2018). Macedonia's EU integration: Progress and challenges with economic reforms. DOI: 10.33107/ubt-ic.2018.399
7. Matoshi, P. R. (2018). The development of tourism enterprises in the municipality of Peja. *Academic Journal of Business*, 4(3). ISSN 2410-3918.
8. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2019). Alternative energy generation and its economic impact on developing countries: A case study of Albania, Kosovo, Montenegro, and Northern Macedonia. DOI: 10.33107/ubt-ic.2019.379
9. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2019). Social Market Economy as an alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans. *Economic Vision*, University of Tetovo, Vol 6, pp. 180-191.
10. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2020). Resurgence of transition economics: Brexit as an expected example, experience and lesson. Online at <https://mpra.ub.uni-muenchen.de/107852/> MPRA Paper No. 107852
11. Ibraimi, Selim and Matoshi, Ruzhdi, (2020). "RUSSIAN DISINFORMATION IN THE BALKANS" *UBT International Conference*. https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2020/all_events/62 DOI 10.33107/ubt-ic.2020.494.
12. Aliu, F., Mulaj, I., & Matoshi, R. (2021). Phillips Curve in Self-management Socialism of Yugoslavia. DOI: [10.33107/ubt-ic.2021.530](https://doi.org/10.33107/ubt-ic.2021.530).
13. Mulaj, Isa & Matoshi, Ruzhdi, (2021). "When the Left gets it Right: landslide victories in the U.S. presidential and Kosovo parliamentary elections," MPRA Paper 113919, University Library of Munich, Germany

14. Matoshi, R, Mulaj, I., Aliu, F (2021). Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe: gjendja, problemet detyrat, ISBN 978-608-4915-13-3

Në periudhën në fjalë Prof.dr. Ruzhdi Matoshi ka të publikuara një varg të punimeve shkencore në përmbledhje të punimeve nga takime shkencore/profesionale me bord editorial vendor dhe ndërkombëtarë:

1. Nuredini, B., & Matoshi, R. (2022). Business ethics and corporate social responsibility comparative approach between capitalism, socialism and Islamic economy [Special issue]. *Corporate Governance and Organizational Behavior Review*, 6(4), 208–220. <https://doi.org/10.22495/cgobrv6i4sip2>
2. Nuredini, B., & Matoshi, R. (2021). Legal Regulation of the Limited Liability Company in North Macedonia, Albania, and Kosovo. *Balkan Social Science Review*, 18, 183-205.
3. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2021). The Paradox of Large Scale Emigration for Economic Reasons from the Western Balkans. UDK: 314.15-029:33(497-15)"20"
Siç mundet të vërehet dhe nga tabelat në shtojcë të raportit, Prof. dr. Ruzhdi Matoshi në periudhën në fjalë ka grumbulluar gjithsej 72 pikë në pjesën e veprimtarisë shkencore-hulumtuese.

Veprimtaria me interes më të gjerë

Në periudhën e deritanishme Prof. dr. Brikend Aziri në vazhdimësi ka qenë në disa trajnime:

- Washington D.C dhe New York citz – *Title of qualification awarded – Participants Training program – Macedonia. 2-29 April – 2006.*
- *South East European University in Tetov: Title of qualification awarded. European Commission TEMPUS "STATS", 6-17 September 2010.*
- *Anniversary of the Fall of Communist System", University for Business and Technology, Pristina, dhe Swidish-Kosovar Scientific Institute, November 2019,*
- *2018 – Macedonia in NATO. Challenges before acceptance of the invitation, Hotel LIRAK, Tetovo.*
- *2021 – Seminar for registration of the households and population in the Republic of North Macedonia. International University of Struga, March 2021.*

Vlen të theksohet fakti se Prof. dr. Ruzhdi Matoshi ka shërbyer në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës Dekan i Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit Ndërkombëtar të Strugës.

Ai është edhe anëtarë i Këshillit për bashkëpunim dhe besim me publikun në Fakultetin Ekonomik pranë kolegjit UBT – Prishtinë, si dhe ka qenë anëtar dhe kryetar i më shumë komisioneve për zgjedhje dhe rizgjedhje të mësimdhënësve në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit Ndërkombëtar të Strugës.

Përfundimi dhe propozimi

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtarinë mësimore dhe arsimore, shkencore e hulumtuese, aplikuese profesionale dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Prof. Dr. Ruzhdi Matoshi** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ka grumbulluar gjithsejtë 266.15 pikë nga referencat profesionale. Me këtë e ka tejkaluar numrin e nevojshëm të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni recensues konstaton se: **Prof. dr. Ruzhdi Matoshi** posedon cilësi shkencore-profesionale bazuar në Ligjin për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës. Komisioni ka verifikuar se kandidati **Prof. dr. Ruzhdi Matoshi i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen Mësimore-Shkencore Profesor inordinar**. Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimorë-Shkencorë të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, që kandidati **PROF. DR. RUZHDI MATOSHI** të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **PROFESOR INORDINAR** në lëmit: Marketing, të tjera (50325, 50329 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencore-hulumtuese sipas klasifikimit ndërkombëtar të fraskatit), në të gjitha programet studimore në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.

Tetovë, 30.Nëntor.2023

Komisioni:

Prof.dr. Brikend Aziri, Kryetar

Prof.dr. Raman Ismaili, Anëtar

Prof.dr. Aida Yzeiri-Baftijari, Anëtar

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË MËSIMDHËNIE DHE SHKENCORE,
TITIJ SHKENCORË, MËSIMORË DHE PROFESIONALË DHE BASHKËPUNUES

Kandidati:
Ruzhdi Islam Matoshi

Institucioni:
Universiteti i Tetovës

Fusha shkencore: Marketing

Për një kandidat që ka më shumë se 4 (katër) punime shkencore në një botim shkencor referues, Komiteti i Shqyrtimit do të listojë, vlerësojë dhe vlerësojë dokumentet shkencore në Modelin 2.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË PROFESIONIN MËSIMOR DHE SHKENCOR – PROFESOR I ASOCIUAR/PROFESION SHKENCOR – SHKENCOR I LARTË

Numri i rreshtit	TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME	Kushtet e përgjithshme po/jo
1	Suksesi i vlerësuar prej së paku 8.00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël në veçanti, ka arritur një sukses mesatar prej të paktën 8.00 (tetë) studime të integruara nga cikli i parë dhe i dytë *	Po
2	Diplomë Shkencore – Doktor i Shkencave në fushën shkencore për të cilën Emri drejtimit Shkencore: Marketing, Fusha SHkenca Ekonomike, Zona Shkenca Shoqerore	PO
3	Të paktën pesë punime shkencore të shqyrtuara janë botuar në një botim shkencor referues në përputhje me ZVO në pesë vitet e fundit përpara publikimit të konkursit të përzgjedhjes	Po
3.1	Një revistë shkencore në të cilën gazetat e botuara janë subjekt i shqyrtimit dhe indeksimit në të paktën një bazë elektronike të revistave me dokumente të disponueshme në Internet, si; Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër revistash që do të themelojnë Listën Shkencore të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë në xoe 1. Emri i revistës shkencore: Corporate Governance and Organizatonal	

	<p>Behavior Revie</p> <p>2. Emri i bazës së revistës elektronike: Scopus</p> <p>Emri i punimit: Business ethic and corporate social responsibility comparative approach between capitalism, socialism and Islamic economy</p> <p>Data e publikimit: 2022</p>	PO
3.2	<p>Revista shkencore në të cilën gazetatat e botuara janë subjekt i Shqyrtimi dhe që ka një bord editorial ndërkombëtar që përfshin anëtarë nga të paktën tre vende, me numrin e anëtarëve nga një vend i paaftë për të kapërcyer dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve</p> <p>1.Name i revistës shkencore: Economic vision-international scientific</p> <p>2.International Editorial Board (numri i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendit):</p> <p>3. Emri i veprës: Social Market Economy as an alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans</p> <p>4. Data e Publikimit:2019</p>	PO
3.3	<p>Revista shkencore në të cilën botohen gazetatat janë subjekt i shqyrtim dhe publikim në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe/ose OECD</p> <p>1.Name i revistës shkencore:</p> <p>2.Name e Vendeve Anëtare të BE-së/ OECD</p> <p>3.Emri i punës:</p> <p>4.Datum mbi botimin:</p>	JO
3.4	<p>Seminari i punimeve shkencore të shqyrtuara të paraqitura në tubimet akademike ndërkombëtare ku anëtarët e programit ose komitetit shkencor janë nga të paktën tre vende</p> <p>1.Name e seminarit: Balkan Social Science Review</p> <p>2.Name e tubimit ndërkombëtar:</p> <p>3.Emrat e vendeve:</p> <p>4. Emri i punës: Legal Regulation of the Limited Liability Company in North Macedonia, Albania, and Kosovo</p> <p>5.Data e lëshimit: 18/12, 2021</p>	PO

3.5	<p>Përkthimi i veprave kapitale në fushat e themeluara nga Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe kërkimin e hulumtim shkencor</p> <p>Emri i veprës së përkthyer rob: Terminologjia e ekonomise ne gjuhen shqipe gjendja dhe problemet detyrat</p> <p>2. Data e lëshimit 2022</p> <p>Botuesi, vendi i botimit dhe viti Agjencioni per implemetim te gjuheve, Shkup , 2022</p>	PO
4	<p>Zgjedhje në thirjen mesimore shkencore professor Inordinar me datën. 02.12. 2020</p>	PO
5	<p>Ai ka aftësinë për të kryer veprimtari të arsimit të lartë</p> <p>Emri i institucionit në të cilin fitohen aftësitë dhe aftësitë për të kryer veprimtaritë e arsimit të lartë Në Fakultetin Ekonomik, Universiteti I Tetovës, Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, Universiteti nderkombetar I Strugës dhe Universiteti ukshin Hoti në Prizren si mësimdhënës në ciklin e pare dhe të dytë të studimeve.</p> <p>Lloji i trajnimit/përvojës/edukimit për marrjen e aftësive dhe aftësive për të kryer veprimtaritë e arsimit të lartë si Ligjerues dhe hulumtues.</p> <p>Periudha e përvetësimit të aftësive për kryerjen e aktiviteteve të arsimit të lartë 2011 – aktualisht në vijim.</p>	

MËSIMDHËNIA DHE VEPRIMTARIA ARSIMORE

Aktiviteti	Kalkulimi	Pikë
ZHVILLIMI I USHTRIMEVE		
<i>Zhvillimi i ushtrimeve në ciklin e parë të studimeve</i>		
Viti 2019, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	2X15X0.03	0.9
Agroturizmi	2X15X0.03	0.9
Viti 2019, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Strategjitë Ndërkombëtare për Biznes	2X15X0.03	0.9
Punët praktike në biznesin ndërkombëtar	2X15X0.03	0.9
Viti 2020, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	2X15X0.03	0.9
Puna praktike e biznesit ndërkombëtar	2X15X0.03	0.9
Strategjitë Ndërkombëtare për Biznes	2X15X0.03	0.9
Viti akademik 2020, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Ekonomia e Agroturizmit	2X15X0.03	0.9
Biznesi Ndërkombëtar	2X15X0.03	0.9
Viti akademik 2021, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	2X15X0.03	0.9
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	1X15X0.03	0.45
Viti 2021, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Kërkimet e tregut	2X15X0.03	0.9
Kërkimet e Marketingut	2X15X0.03	0.9
Viti akademik 2022, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	2X15X0.03	0.9
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	1x15x0.03	0.45
Viti akademik 2022, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Kërkimet e Tregut	2X15X0.03	0.9
Kërkimet e Marketingut	2X15X0.03	0.9
Viti akademik 2023, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	2x15x0.03	0.9
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	1x15x0.03	0.45
Viti akademik 2023, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Kërkimet e Tregut	2X15X0.03	0.9

Kërkimet e Marketingut	2X15X0.03	0.9
Gjithsejt pikët		17.55
Aktiviteti	Kalkulimi	Pikë
ZHVILLIMI I LIGJËRATAVE		
Zhvillimi i ligjëratave në ciklin e parë të studimeve		
Viti 2019, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	4X15X0.04	2.4
Agroturizmi	4X15X0.04	2.4
Kolegji UBT		
Meaxhimi Publik	4X15X0.04	2.4
Politikat e qeverisjes lokale	4X15X0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Hyrje në menaxhment	4X15X0.04	2.4
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	4X15X0.04	2.4
Viti 2019, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Strategjitë Ndërkombëtare për Biznes	4x15x0.04	2.4
Punët praktike në biznesin ndërkombëtar	4x15x0.04	2.4
Kolegji UBT		
Politikat për menaxhimin publik	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Menaxhimi i burimeve njerëzore	4x15x0.04	2.4
Menaxhimi i biznesit të vogës	4x15x0.04	2.4
Viti 2020, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	4x15x0.04	2.4
Puna praktike e biznesit ndërkombëtar	4x15x0.04	2.4
Strategjitë Ndërkombëtare për Biznes	4x15x0.04	2.4
UBT-Prishtinë		
Menaxhimi publik	4x15x0.04	2.4
Politikat e qeverisjes lokale	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Hyrja në menaxhment	4x15x0.04	2.4
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	4x15x0.04	2.4
Viti akademik 2020, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Udhëheqja me sektorin publik	4x15x0.04	2.4
Ekonomia e Agroturizmit	4x15x0.04	2.4
Biznesi Ndërkombëtar	4x15x0.04	2.4
UBT-Prishtinë		
Politikat e Administrimit Publik	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Biznesi i vogël	4x15x0.04	2.4
Menaxhmenti Ndërkombëtar	4x15x0.04	2.4
Viti akademik 2021, semestri veror		

Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	4x15x0.04	2.4
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	4x15x0.04	2.4
UBT-Prishtinë		
Menaxhimi Publik	4x15x0.04	2.4
Qeverisja e pushtetit lokal	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Menaxhmenti Ndërkombëtar	4x15x0.04	2.4
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	4x15x0.04	2.4
Viti 2021, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Kërkimet e tregut	4x15x0.04	2.4
Kërkimet e Marketingut	4x15x0.04	2.4
UBT-Prishtinë		
Politikat e Administrimit Publik	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4x15x0.04	2.4
Menaxhimi i Biznesit të Vogël	4x15x0.04	2.4
Viti akademik 2022, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	4x15x0.04	2.4
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	4x15x0.04	2.4
UBT-Prishtinë		
Menaxhimi Publik	4x15x0.04	2.4
Politikat e qeverisjes lokale	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Hyrja në menaxhment	4x15x0.04	2.4
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	4x15x0.04	2.4
Viti akademik 2022, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Kërkimet e Tregut	4x15x0.04	2.4
Kërkimet e Marketingut	4x15x0.04	2.4
UBT-Prishtinë		
Politikat e Administrimit Publik	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4x15x0.04	2.4
Menaxhimi i Biznesit të Vogël	4x15x0.04	2.4
Viti akademik 2023, semestri veror		
Universiteti i Tetovës		
Distribucioni	4x15x0.04	2.4
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	4x15x0.04	2.4
UBT - Prishtinë		
Politikat e Administrimit Publik	4x15x0.04	2.4
Etika në Administratnë Publike	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Biznesi i Vogël	4x15x0.04	2.4

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4x15x0.04	2.4
Viti akademik 2023, semestri dimëror		
Universiteti i Tetovës		
Kërkimet e Tregut	4x15x0.04	2.4
Kërkimet e Marketingut	4x15x0.04	2.4
UBT-Prishtinë		
Politikat e Administrimit Publik	4x15x0.04	2.4
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4x15x0.04	2.4
Menaxhimi i Biznesit Vogël	4x15x0.04	2.4
Gjithsejt pikët		136.8
Cikli i dytë		
Viti 2019, semestri veror dhe dimëror		
UBT-Prishtinë		
Intership dhe Zhvillimi profesional	3x15x0.05	2.25
Politikat për udhëheqjen e mjedisit	3x15x0.05	2.25
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
E - Ekonomia	3x15x0.05	2.25
Viti akademik 2020, semestri veror dhe dimëror		
UBT-Prishtinë		
Intershipi	3x15x0.05	2.25
Qeverisja lokale, financat dhe rregullimi	3x15x0.05	2.25
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
Menaxhmenti i burimeve njerëzore	3x15x0.05	2.25
Viti akademik 2021, semestri veror dhe dimëror		
UBT-Prishtinë		
Intership dhe Zhvillimi profesional	3x15x0.05	2.25
Qeverisja lokale, financat dhe rregullimi	3x15x0.05	2.25
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
E-Ekonomia	3x15x0.05	2.25
Viti akademik 2022, semestri veror dhe dimëror		
UBT-Prishtinë		
Intership dhe zhvillimi profesional	3x15x0.05	2.25
Politikat e Qeverisjes Lokale, financat dhe rregullat	3x15x0.05	2.25
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
E-Ekonomia	3x15x0.05	2.25
Viti akademik 2023, semestri veror dhe dimëror		
UBT-Prishtinë		
Intershipi dhe zhvillimi profesional	3x15x0.05	2.25
Politikat e qeverisjes lokale, financat dhe rregullat	3x15x0.05	2.25
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës		
E-Ekonomia	3x15x0.05	2.25
Gjithsejt Pikët		33.75
Gjithsejt pikët nga aktiviteti mësimdhënës		154.35
PËRGADITJE E LËNDËS SË RE		
<i>Përgaditje e ligjeratave në lëndë të re</i>		

Menaxhimi Publik	1	1
Marketingu Bankar	1	1
Hyrje në Ekonomi në Ndërtimtari	1	1
Menaxhim Publik	1	1
Menaxhim Marketingu	1	1
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	1	1
Intership dhe Zhvillimi Profesional	1	1
Distribucioni	1	1
Promocioni	1	1
Kërkimet e Tregut	1	1
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore	1	1
Qeverisja e Pushtetit Lokal	1	1
Politika e Qeverisjes Lokale – Financat dhe Rregullimi	1	1
Politikat e Administrimit Publik	1	1
Ekonomia Evropiane	1	1
<i>Përgaditje e ushtrimeve në lëndë të re</i>		
Distribucioni	1.5	1.5
Kërkimet e Tregut	1.5	1.5
GJITHSEJ PIKË NGA PËRGADITJA E LËNDËVE TË REJA	18	
KONSULTA ME STUDENTË		
Viti akademik 2016-2017		
Viti akademik 2016-2017	99x0.002	0.198
Viti akademik 2017-2018	120x0.002	0.243
Viti akademik 2018-2019	88x0.002	0.176
Viti akademik 2019-2020	92x0.002	0.184
Viti akademik 2020-2021	70x0.002	0.143
Viti akademik 2021-2022	55x0.002	0.111
Viti akademik 2022-2023	92x0.002	0.184
GJITHSEJ PIKË NGA KONSULTAT ME STUDENTË	1.2	
MENTORIM I PUNIMEVE TË DIPLOMIT		
Gresa Neziri: "Etika në Menaxhimin Publik. Mbrojtur më datë Pranverë, muaji.05.2019	1x0.2	0.2
Igballe Hyseni: "Etika në Menaxhimin Publik-Rast studimi në bifurkacionin Ferizaj: "Vjeshtë, muaji 09. 2020.	1x0.2	0.2
Rrinor Gashi:"Etika si sfidë në Menaxhimin e Burimeve Njerëzo". Mbrojtur më Vjeshtë, muaji 11, 2020	1x0.2	0.2
Blerona Aliu: "Planifikimi Strategjik në rritjen e shërbimeve publike, Prishtinë. Mbrojtur në dimër, muaji 12, 2019	1x0.2	0.2
Elona Saiti: "Performanca e punonjësve në komunën e Ferizajit. Mbrojtur më vjeshtë, muaji 9, 2018	1x0.2	0.2
Fatime Aliu: "Etika në Menaxhimin Publik – Rrast studimi, shtëpia e shëndetit Liplan". Mbrojtur në verë, muaji 7, 2020	1x0.2	0.2
Gresa Konjufca: "Roli i financave publike në zgjedhjet elektorale në periudhën e pasluftës në Kosovë". Mbrojtur më dimër, muaji 12, 2017	1x0.2	0.2
Duan Tairbegolli: "Partitë politike në Kosovë, profilizimi dhe	1x0.2	0.2

funkcionimi i tyre". Mbrojtur në Vjeshtë, muaji 9, 2020.		
GJITHSEJ PIKË NGA MENTORIMI I PUNIMEVE TË DIPLOMIT	1.6	
ANËTAR I KOMISIONIT PËR VLERËSIM OSE MBROJTJE TË PUNIMIT TË DOKTORATËS		
Anëtar komisioni nga për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të doktoratës	2 X 1.5	3
ANËTAR I KOMISIONIT PËR VLERËSIM OSE MBROJTJE TË PUNIMIT TË MAGJISTRATURËS		
Anëtar komisioni për vlerësim ose mbrojtje të punimit të magjistraturës	30 X 0.5	15
Mentorim i punimeve të magjistraturës		
SKRIPTË INTERNE NGA LIGJERATAT		
Sistemet Ekonomike Bashkëkohore, Tetovë, 2019	4	4
GJITHSEJ PIKË NGA PËRKADITJA E SKRIPTAVE INTERNE PËR LIGJERATA	4	
MENTOR NË DISERTACION MAGJISTRATURE TË MBROJTUR ME SUKSES		
10 kandidatë në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës	10 x 1	10
5 kandidatë në Kolegjin UBT	5 X 1	5
GJITHSEJ PIKË NGA MENTORIMI I DISERTACIONEVE TË MAGJISTRATURËS TË MBROJTURA ME SUKSES	15	
Gjithsejt pikët nga aktiviteti – mësimdhënia dhe veprimtaria mësimore	194.15	

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

PJESËMARRËS NË PROJEKT HULUMTUES NACIONAL		
Anniversary of the Fall of Communist System", University for Business and Technology, Pristina, dhe Swidish-Kosovar Scientific Institute, November 2019,	1x3	3
2021 – Seminar for registration of the households and population in the Republic of North Macedonia. International University of Struga, March 2021	1x3	3
GJITHSEJ PIKË NGA PJESËMARRJA NË PROJEKTE HULUMTUESE NACIONALE	6	
PUNIM ME REZULTATE ORIGINALE SHKENCORE TË BOTUARA NË REVISTA SHKENCORE/PROFESIONALE		
1. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2019). Alternative energy generation and its economic impact on developing countries: A case study of Albania, Kosovo, Montenegro, and Northern Macedonia. DOI: 10.33107/ubt-ic.2019.379	5	5
2. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2019). Social Market Economy as an alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans. Economic Vision, University of Tetovo, Vol 6, pp. 180-191.	5	5
3. Matoshi, R., & Mulaj, I. (2020). Resurgence of transition economics: Brexit as an expected example, experience and lesson. Online at https://mpr.aub.uni-muenchen.de/107852/ MPRA Paper No. 107852	5	5
4. Ibraimi, Selim and Matoshi, Ruzhdi, (2020). "RUSSIAN DISINFORMATION IN THE BALKANS" UBT International Conference.	5	5

	https://knowledgecenter.ubt.uni.net/conference/2020/all_events/62_10.33107/ubt-ic.2020.494 .		
5.	Aliu, F., Mulaj, I., & Matoshi, R. (2021). Phillips Curve in Self-management Socialism of Yugoslavia. DOI: 10.33107/ubt-ic.2021.530	5	5
6.	Mulaj, Isa & Matoshi, Ruzhdi, (2021). "When the Left gets it Right: landslide victories in the U.S. presidential and Kosovo parliamentary elections," MPRA Paper 113919, University Library of Munich, Germany	5	5
7.	Matoshi, R, Mulaj, I.,Aliu, F (2021). Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe: gjendja, problemet dhe detyrat, ISBN 978-608-4915-13-3	3	3
GJITHSEJ PIKË NGA BOTIMI I PUNIMEVE ME REZULTATE ORIGJINALE SHKENCORE NË REVISTA SHKENCORE PROFESIONALE		33	
PUNIME ME REZULTATE ORIGJINALE SHKENCORE TË BOTUARA NË REVISTA SHKENCORE/PROFESIONALE ME BORD EDITORIAL NDËRKOMBËTAR			
1.	Nuredini, B., & Matoshi, R. (2022). Business ethics and corporate social responsibility comparative approach between capitalism, socialism and Islamic economy [Special issue]. Corporate Governance and Organizational Behavior Review, 6(4), 208–220. https://doi.org/10.22495/cgobrv6i4sip2	6	6
2.	Nuredini, B., & Matoshi, R. (2021). Legal Regulation of the Limited Liability Company in North Macedonia, Albania, and Kosovo. <i>Balkan Social Science Review</i> , 18, 183-205.	6	6
1.	Matoshi, R., & Mulaj, I. (2021). The Paradox of Large Scale Emigration for Economic Reasons from the Western Balkans. UDK: 314.15-029:33(497-15)"20"	5	5
GJITHSEJ PIKË NGA BOTIMI I PUNIMEVE ME REZULTATE ORIGJINALE SHKENCORE NË REVISTA SHKENCORE PROFESIONALE ME BORD NDËRKOMBËTAR		17	
PJESËMARRJE NË TUBIM SHKENCOR PROFESIONAL ME REFERAT			
	International Scientific Conference on Business and Economics, Tetovo, November, 2019	1x2	2
	International Scientific Conference on Business and Economics, Tetovo, November, 2020	1x2	2
	International Scientific Conference on Business and Economics, Tetovo, November, 2021	1x2	2
	International Scientific Conference on Business and Economics, Tetovo, November, 2022	1x2	2
	International Scientific Conference on Business and Economics, Tetovo, November, 2023	1x2	2
GJITHSEJ PIKË NGA PJESËMARRJA NË TUBIME SHKENCORE PROFESIONALE ME REFERAT		10	
GJITHSEJ PIKË NGA VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE		72	

REFERENCAT E PROF. DR. RUZHDI MATOSHI PËR ZGJIDHJE NË THIRRJE MË TË LARTË MËSIMORE-SHKENCORE

FUSHA E VEPRIMTARISË	PIKË
Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore	194.15
Veprimtaria shkencore-hulumtuese	72
Veprimtaria profesionale artistike aplikative	/
Veprimtaria me interes më të gjerë	/
GJITHSEJ	266.15

Tetovë, 30.Nëntor 2023

Komisioni:

Prof.dr. Brikend Aziri, Kryetar

Prof.dr. Raman Ismaili, Anëtar

Prof.dr. Aida Yzeiri- Baftjari, Anëtar

Drejtuar:
Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik
pranë Universitetit të Tetovës

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË
GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIT BISNIS MENAXHMENT, TË TJERA (50603,
50624 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORE-HULUMTUESE SIPAS
KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË FAKULTETIN EKONOMIK PRANË UNIVERSITETIT
TË TETOVËS**

Në bazë të konkursit të shpallur më datë 18.Nëntor.2023, në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat”, dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2023, ka sjell Vendim për formim të Komisionit recensues me nr. 14-865/3, për zgjedhjen e një asistenti në lëmin Biznes menaxhment, të tjera (50603, 50624 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencore-hulumtuese sipas klasifikimit ndërkombëtar të Fraskatit), në përbërje:

1. Prof.dr. Brikend Aziri, Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës,
2. Prof.dr. Raman Ismaili, Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës,
3. Prof.dr. Arjeta Amzai, Profesor inordinar në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit të Tetovës.

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni në fjalë vërtetoi se në konkurs janë paraqitur kandidatët në vijim:

1. Mr. Gonxhe Osmani, me fletë aplikacion nr. 04-02/14.
2. Mr. Artina Zeqiri Limani, me fletë aplikacion nr. 04-01/14.
3. Mr. Arta Thaçi, me fletë aplikacion nr. 04-04/14
4. Mr. Era Memeti, me fletë aplikacion valid.

Komisioni pas shqyrtimit të vëmendshëm të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e kandidatëve në fjalë, e në përputhshmëri me kërkesat në nenin 170 të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë dhe kërkesat e vetë Konkursit në fjalë, dorëzon këtë:

RAPORT RECENSUES

Më datë 18.11.2023, në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat”, dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, është shpallur konkurs për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës edhe ate Një asistent në lëmin Biznis menaxhment, Të tjera (50603, 50624 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit). Bazuar në dokumentacionin e pranuar, të kandidatit MSc Artina Zeqiri Limani komisioni paraqet referat me të dhëna si më poshtë.

Të dhëna biografike

Artina Zeqiri Limani ka lindur më 15 Maj 1996 në Tetovë- Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollën e mesme e ka mbaruar me sukses të shëlqyeshëm në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” drejtimi matematiko-natyror në Tetovë. Studimet i vazhdoi në Universitetin e Evropës Juglindore Tetovës në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë në drejtimin Menaxhment dhe Marketing. Në vitin 2015 ajo u dekorua nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në RMV me mirënjohje si studente e dalluar. Artina është bursiste e Erasmus Plus, ku për një semestër ka studiuar në Universitetin e Bambergut në Gjermani. Në vitin 2015 Artina prezantoi UEJL-në në garat për oratori, e realizuar në mes të universiteteve në vend nga Lëvizja Evropiane, ku edhe morri cmimin e parë. Sukseset në studimet deridiplomike e rradhiten atë si studente e gjeneratës ku u dekorua me certifikate për suksesin e arritur gjatë ceremonisë së diplomimit. Përgjatë studimeve ajo u angazhua vullnetarisht në zyrën e financave në kompaninë private “Green Product”.

Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë në drejtimin Menaxhment. Gjatë kësaj perjudhe ajo u nominua nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të prezentuar RMV-në në SHBA përmes programit të Departamentit Amerikan “IVLP” në fushën e qëndrueshmërisë së sektorit civil.

Në vitin 2017 ajo u zgjodh antare e Këshillit Rinor të Ambasadës së SHBA-ve në Shkup . Gjatë këtij viti ajo punësohet si gazetare fillimisht në televisionin kombëtar -Art Channel dhe më pas në Klan Macedonia ku për pesë vite deri në vitin 2022 ajo ka mbuluar kronika dhe lajme nga fusha e ekonomisë , sociale dhe fusha politike. Ka intervistuar zyrtarë të lartë dhe përfaqësues të institucioneve publike për tema me interes publik.Përgjatë punës në këtë televizion ajo krijon produktin e parë me autorësi të saj gjegjësisht emisionit të parë debatit rinor që në fokus kishte zhvillimin e mendimit kritik tek të rinjtë mbi aktualitetin politik dhe ekonomik në vend “Odë Rinore”.

Artina mbaroi studimet pasdiplomike me sukses në drejtimin Menaxhment, në Universitetin e Evropës Juglindore ku dhe mbrojti temën e magjistraturës “Roli i komunikimit efektiv dhe kulturës organizative në performancën e biznesit”.

Nga viti 2018 ajo është e angazhuar si hulumtuuese në sektorin civil gjegjësisht në Shoqatën për Avansimin e Demokracisë në vend “Democracy Lab”. Deri tani ajo ka udhëhequr në pozitën e asistent menaxherit programin “Young Journalists” e mbëtetur nga Ambasada e SHBA-ve në Shkup. Ka qene kordinatore e projektit për rritje të transparencës në komunat lokale kryesisht në Komunën e Tetovës; si dhe ndihmës kordinatore në projektin për rritje të pjesmarjes së qytetare në vendimarrjen lokale- “Çairi Vendos”.

Nga viti 2020 ajo është angazhuar si asistente (staf i jashtëm) në lëndët Menaxheriale pranë Universitetit të Tetovës.

Nga viti 2022 Artina kordinon procesin administrativ të grandeve për bizneset në RMV si dhe mbështetjen e “Start Up Bizneseve” në kuadër të shtyllës së tretë të planit për zhvillim ekonomik të qeverisë së Maqedonisë së Veriut por dhe Bankës Botërore pranë Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Ekonomik.

Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore

